

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Roberto Carlos, nga 160 mln. euro te asgjëja...
ADRESA	https://dosja.al/sport/roberto-carlos-nga-160-mln-euro-te-asgjëja-i516523
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 13:07:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 13:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ec20d5f13f2fefeaa40736851957156b77d53779369e5a772e8fb1a5d98cd7351
TEKSTI	228ba31e818e1eabc7f9f7d919d955cb65f590cc03bf430a144de0e78d89990c
PAMJA	7c0ed1b7bfccafa2f693d27fd402d2e927572369704dd0b9455f0247d64a1713

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	513f837a388e5c146e55bceb06089e0c301275a51bba2a60ff383aed8a025659
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c9da2c073e2a83be1965121fd231137d695108173d39514ad5452b64d4c51b05
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/513f837a388e5c146e55bceb06089e0c301275a51bba2a60ff383aed8a025659>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

53 MINUTA ME PARE

Pagat e magistratëve/ GJL dhe shoqatat e gjyqtarëve nuk marrin pjesë në tryezën e Ramës. Kryeministria: Do vazhdojmë punën për ligjin e pagave

3 ORE ME PARE

Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder tregon detyrat: Kapitujt duhen mbyllur. Rama: Europa mos të na lërë në baltë, do jetë dështim

4 ORE ME PARE

Përfundon mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, në fokus hetimi ndaj ish-drejtoreshës së SHISH dhe siguria e informacionit të klasifikuar

20 ORE ME PARE

120 ditë protestë/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, me thirrje e pankarta në duar: Rama jep dorëheqjen

Sport

Roberto Carlos, nga 160 mln. euro te asgjëja...

11 fëmijë, 7 gra, 3 Champions, një Kupë Bote dhe një pasuri që, sipas rrëfimit të tij, u zhduk. Historia e jashtëzakonshme e legjendës braziliane, mes lavdisë, luksit, polemikave dhe dramës financiare.



28 Shtator 2026, 15:00
Nga DOSJA



BRAZIL - Një këmbë e majtë që trembte portierët, miliona euro në bankë, trofe pa fund dhe një jetë që shpesh dukej si një film. Roberto Carlos i kishte pothuajse të gjitha. Sot, 53 vjeç, legjenda braziliane rrëfen një tjetër kapitull: sipas tij, pasuria që ndërtoi gjatë karrierës është zhdukur.

Goditjet e tij të dënimit ishin të paparashikueshme. Topi nisej drejt portës dhe, në një moment kur dukej se gjithçka ishte e qartë, ndryshonte trajektore në mënyrë të pabesueshme.

Edhe jeta e Roberto Carlosit duket sikur ka ndjekur të njëjtën logjikë. Nga varfëria në Brazil te majat e futbollit botëror. Nga një fabrikë tekstilësh te Real Madridi. Nga miliona euro te një rrëfim për llogari bankare të boshatisura.

Një jetë me trofe, gra, fëmijë, festa, miqësi, polemika dhe, tani, një dramë financiare.

NJË JETË QË DUHET TA NUMËROSH ME SHIFRA

11 fëmijë. 7 gra. 2 martesë. 25 trofe. 3 Champions League. 1 Kupë Bote. 125 ndeshje me Brazilin. 527 ndeshje me Real Madridin.

Shifrat tregojnë vetëm një pjesë të historisë.

Roberto Carlos ishte një nga mbrojtësit më të fuqishëm të brezit të tij, por në shumë aspekte luante si një sulmues. Vraponte pa pushim, godiste me forcë të jashtëzakonshme dhe kishte një nga të majtat më të famshme të historisë së futbollit.

Në vitin 1997, në Lion, kundër Francës, erdhi një prej momenteve që do ta përtësonte. Goditja e dënimit u nis në një trajektore që dukej sikur po largohej nga porta. Pastaj topi ndryshoi drejtim dhe përfundoi në rrjetë.

Shpejtësia e goditjes është vlerësuar rreth 137 km/h.

editoriale

Meri Lika

Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Enton Abilekaj

Labirinti i errët i Edi Ramës

Në vëmendje

POLITIKE 28 SHTATOR 2026, 13:36

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 13:01

FOTOLAJM/ Kush janë dy të rinjtë që tentuan të mashtronin Armand Dukën dhe lidhja me Florian Gjergjin

POLITIKE 28 SHTATOR 2026, 11:21

Që nga ajo ditë, goditja e Roberto Carlosit nuk ishte më thjesht një goditje dënimi. U bë një fenomen.

NGA FABRIKA E TEKSTILEVE TEK SANTIAGO BERNABÉU

Sot është e vështirë të imagjinosh se një prej yjeve më të mëdhenj të futbollit botëror dikur punonte në një fabrikë tekstilësh.

Roberto Carlos lindi në Garça, në shtetin e São Paulos, në një familje të varfër. Ishte vetëm 12 vjeç kur nisi të punonte. Futbolli do t'i ndryshonte gjithçka.

Interi e mori në vitin 1995, ndërsa më pas erdhi transferimi që do ta kthente në legjendë: Real Madridi.

Në Madrid kaloi 11 vjet, fitoi gjithçka dhe u bë një nga figurat më të rëndësishme të skuadrës. Tre Champions League dhe një Kupë Bote me Brazilin janë vetëm disa prej kapitujve të karrierës së tij.

160 MILIONË EURO – DHE PASTAJ... ASNJË QINDARKË?

Këtu historia merr një kthesë të jashtëzakonshme. Roberto Carlos ka deklaruar se gjatë karrierës ka fituar rreth 160 milionë euro. Sot, sipas rrëfimit të tij, kjo pasuri nuk ekziston më.

Ai ka folur për njerëz të besuar që e kanë mashtruar, probleme me menaxhimin e parave dhe një seri vendimesh financiare që kanë sjellë humbje kolosale.

Një njeri që për vite me radhë ishte simbol i luksit dhe suksesit financiar, tashmë rrëfen një realitet krejt tjetër. Është një prej atyre historive që të bëjnë të pyesësh: si mund të humbasë një pasuri prej 160 milionë eurosh?

RONALDO, FESTAT DHE JETA PA FENA

Roberto Carlos nuk ishte vetëm një futbollist i madh. Ishte edhe një prej personazheve më të njohur të një brezi që jetonte me ritëm të jashtëzakonshëm.

Miqësia me Ronaldo Fenomenin është një nga kapitujt më të famshëm. Të dy njiheshin që prej vitit 1992 dhe, gjatë viteve te Real Madridi, ishin pothuajse të pandarë.

Festat e Ronaldos janë kthyer në histori.

Një autobus me vajza që mbërrin në vilën e Fenomenit, futbollistë që largohen me shpejtësi bashkë me partneret e tyre dhe, në fund, vetëm Ronaldo dhe Roberto Carlos që qëndrojnë.

Dhe pastaj vjen batuta e Roberto Carlosit: “Kam fjetur më shumë net me të sesa me dy gratë e mia.” Një fjali që përmbledh më shumë se çdo biografi mënyrën e jetës së atyre viteve.

30 SEKONDA QË NUK I HARROI KURRË

Por pas festave dhe luksit kishte edhe momente të tjera. Në prag të finales së Botërorit 1998, Francë-Brazil, Roberto Carlos u zgjua nga zhurmat në dhomë dhe kuptoi se Ronaldo nuk ishte mirë.

Ishte rreth 30 sekonda ankth. Ronaldo kishte pësuar një gjendje të rëndë shëndetësore dhe situata krijoi panik në kampin brazilian.

Të nesërmen të dy dolën në fushë. Brazili humbi finalen 3-0. Por ajo natë mbeti një nga episodet më të pazakonta të historisë së Kupës së Botës.

MISTERI I TË MAJTËS

Dhe pastaj është ajo këmbë. Kofshë me perimetër rreth 66–68 centimetra, forcë fizike e jashtëzakonshme dhe një teknikë që dukej sikur sfidonte rregullat e zakonshme të fizikës.

Pas goditjes së famshme në Lion, fizikantë francezë u përpoqën të shpjegonin trajektoren e topit.

Graviteti. Rezistenca e ajrit. Rotacioni. Shpejtësia. Shumë teori. Por asnjë përgjigje që ta shpjegonte plotësisht atë që kishte ndodhur.

Ndoshta sepse Roberto Carlos nuk ishte thjesht një futbollist që godiste fort. Ishte një futbollist që dukej sikur e detyronte topin të bënte gjëra që nuk duhej t'i bënte.

NGA LEGJENDA TEK NJERIU

“Nuk merzitem kurre me Shqipërinë”, Rama ndërpret fjalën e raportuesit për Shqipërinë në PE: Aman, s’i lë dot gjermanët të presin

më të klikuarat

Rama sulmon 2 televizione: Lavatriçe mediatike, kanë marrë peng një Prokuror

Labirinti i errët i Edi Ramës

Reforma në Drejtësi/ Rama: Pa mua, SHBA-ja dhe BE-ja do kishin bërë Noc Rrokun

Hakerat iraniane nxjerrin mbi 600 numra të personelit të SHISH-it, publikojnë edhe dokumente konfidenciale

insights

Bledian Koka
Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by tomorrow

Sot, pas gjithë atyre viteve, Roberto Carlos nuk është më vetëm legjenda e Real Madridit, kampioni i botës apo njeriu i goditjes së pamundur.

Është edhe një njeri që po përballlet me një kapitull tjetër të jetës. Një kapitull ku nuk ka stadione, trofe apo mijëra tifozë.

Ka vetëm kujtimet. Dhe një shifër që duket e pabesueshme: 160 milionë euro. I fitoi në futboll. Sipas rrëfimit të tij, i humbi më pas.

Dhe ndoshta ky është paradoksi më i madh i historisë së Roberto Carlosit: Ai që dikur ndryshonte trajektoren e topit me këmbën e majtë, sot ka parë jetën e tij të ndryshojë trajektore.

B.T (Dosja.al)

Sondazh

Poll

Sport
28 Shtator 2026, 14:30

Pse PSG nuk duhet të bëjë lëvizje për JJ Gabriel, talentin e ri të Man.United?...

FRANCE - Këmbë e djathtë, shpejtësi, teknikë, goditje me top. 15-vjeçari nga Mançesteri i ka të gjitha. Ndërs...

Barça ëndërron një transferim të madh nga Manchester City, nuk është Erling Haaland...

Sport
28 Shtator 2026, 14:00

"Një ekip mesatar" ... Vlerësimi i Schweinsteiger për Gjermaninë, Kimmich dhe Klopp përgjigjen

Sport
28 Shtator 2026, 13:30

Nations League/ Kombëtarja mbyll
përgatitjet në Tiranë dhe niset drejt San
Marinos...

Sport

28 Shtator 2026, 13:21

Dy lojtarë të Barbudës u nxorrën jashtë
fushe, pasi tërhoqën nga flokët një
kundërshtar...

Sport

28 Shtator 2026, 13:00

Sport

28 Shtator 2026, 12:30

Presidenti i La Ligës thërret për 'transparencë' financiare pas dyshimeve të Man.Cityt...

SPANJE - Dy ditë pasi The Athletic zbuloi se Manchester City ishte
shpallur fajtor për 114 nga 115 akuzat kundër tyre për shkelje të...

Për herë të parë pas 18 vitesh, Cristiano
Ronaldo - në stol dhe nuk luajti për
Portugalinë!

Sport

28 Shtator 2026, 12:00

Një gjyqtar debutues hungarez do të
vendosë drejtësi në përballjen San
Marino-Shqipëri

Sport

28 Shtator 2026, 11:30

Italia përballë rrezikut: sa pikë i duhen
për të shpëtuar nga rënia në Ligën B?

Sport

28 Shtator 2026, 11:00

Leo Messi tjetër perlë absolutisht e
çmendur për Inter Miamin, shkon në 76
numri i golave...

Sport

28 Shtator 2026, 10:50

MË SHUMË

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.